



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

Nr. 23/ prot.
175

Tiranë, më 27.12.2024

VENDIM

Nr. 1143, Datë 27.12.2024

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN S&D INVEST SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.12.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen S&D Invest SHA.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 45, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”, miratuar me VKK nr. 437, datë 05.10.2016.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin të hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”;

- Seancës dëgjimore te zhvilluar në datën 23.12.2024 me përfaqësues të ndërmarrjes S&D Invest SHA;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Nisur nga disa ankesa të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, mbi problematikat në zgjedhjen e ofrimit të shërbimit të internetit pranë disa komplekseve të pallateve në Tiranë, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, filloi monitorimin në tregun e ofrimit të shërbimit të internetit pranë disa komplekseve të pallateve në Tiranë.
2. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë periudhës së monitorimit u krijua dyshimi i arsyeshëm se mund të ishim përpara abuzimit me pozitën dominuese nga ndërmarrjet e administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, në kuptim të nenit 9, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
3. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi me Vendimin nr. 1025, datë 18.10.2023 për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023.
4. Gjatë procedurës së hetimit paraprak dhe në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit, u konfirmua edhe më tej se në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e ndërmarrjeve të administrimit mund të përbënte abuzim me pozitën dominuese kryesisht nëpërmjet: refuzimit të aksesit të ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë këtë shërbim; zbatimit të kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe duke krijuar kushtet e favorshme për krijimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve të internetit brenda rezidencës që ata administrojnë.
5. Nisur nga analiza e bërë nga Sekretariati gjatë fazës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u shpreh me Vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.
6. Në zbatim të këtij vendimit, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet e administrimit dhe nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
8. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë” për ndërmarrjen e administrimit tregu përkatës i produktit përfshin, tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim.
9. Në rezidencat e banimit në Tiranë, ndërmarrjet e administrimit menaxhojnë pikën e aksesit në infrastrukturën e shërbimit të internetit. Si të tilla, këto ndërmarrje bëjnë lidhjet me kompanitë e ofrimit të shërbimit të internetit dhe banorëve të cilët duan të përfitojnë këtë shërbim. Në të tilla kushte, ndërmarrjet e administrimit kanë ndikim në tregun e ofrimit të shërbimit të internetit, si dhënës të aksesit në infrastrukturë, në rezidencat ku ata operojnë. Pra, bazuar në këto fakte, tregu përkatës përfshin tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrja S&D Invest SHA ka në administrim.
10. Ndërmarrjet që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda rezidencës që ato administrojnë dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre nuk kanë fuqi jashtë territorit të sipërfaqes së përbashkët që ata administrojnë.
11. Për sa më sipër, tregu përkatës gjeografik për ndërmarrjen S&D Invest SHA, është territori i rezidencave të banimit që kjo ndërmarrje ka në administrim:
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Godina ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Rezidencën , në rrugën
 - Rezidencën , në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

12. Në bazë të nenit 3, pika 5 të Ligjit nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
13. Sipas ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por

zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121/2003.

14. Për të përcaktuar pjesët e tregut të ndërmarrjeve që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku të ishte përcaktuar xhiro dhe fitimi për secilën ndërmarrje administrimi që vepron në qarkun e Tiranës. Në informacionin e depozituar nga DPT, për një pjesë të madhe të ndërmarrjeve mungonin të dhënat përsa i përket xhiros dhe fitimit dhe për këtë arsye, është e pamundur që të llogariten pjesët e tregut për secilën ndërmarrjen administrimi në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit.
15. Ndërmarrjet që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda rezidencës që ato administrojnë dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre nuk kanë fuqi jashtë territorit të sipërfaqes së përbashkët të administruar prej tyre. Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, Kryesia, në emër dhe për llogari të Asamblesë, lidh kontratë me një shoqëri administrimi duke i dhënë kësaj të fundit të drejtën ekskluzive për administrimin e bashkëpronësisë.
16. Pjesë e objekteve në bashkëpronësi të ndërtesave konsiderohet dhe pika e aksesit në godinë sipas pikës 18 të VKM-së nr. 189, datë 30.03.2022 “Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina”, e cila përcakton gjithashtu, në pikën 32 të saj, se administrimi i pikës së aksesit në godinë bëhet pikërisht nga administratori i godinës, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit dhe në përputhje me nenin 21, të Ligjit nr. 120/2016.
17. Për sa më sipër, ndërmarrja S&D Invest SHA, duke qenë administratore e vetme në të gjitha rezidencat/godinat të cilat ajo administron, zotëron 100% të pjesëve të tregut përkatës dhe si rrjedhojë vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e aksesit të shërbimit të internetit brenda kufijve të rezidencave që ata administrojnë.
18. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja S&D Invest SHA në tregun e aksesit të shërbimit të internetit ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

19. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024, është realizuar në vijim të kërkesës për informacion drejtuar ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e internetit.
20. Ndërmarrja S&D Invest SHA administron 11 objekte banimi në qarkun e Tiranës ku ofrojnë

shërbim interneti ndërmarrjet si më poshtë:

- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 100 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 8 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 85 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 5 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Godina ndodhur në rrugën me 27 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 2 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 28 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 8 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 19 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 4 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 33 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 4 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 31 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 4 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 27 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 2 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Rezidencën , në rrugën me 1083 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 4 ndërmarrje, të cilat janë: dhe
- Rezidencën , në rrugën me 291 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 4 ndërmarrje, të cilat janë: Dhe
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën me 20 hyrje, ku ofrojnë shërbim interneti 2 ndërmarrje, të cilat janë: dhe

21. Ndërmarrja S&D Invest SHA në shkresën nr. 23/101 prot., datë 04.07.2024 shprehet se rrjeti i shpërndarjes në rezidencën është realizuar nga ndërmarrja dhe në raste specifike i është mundësuar akses dhe kompanive të tjera.

22. Gjatë procedurës së hetimit paraprak ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës, për rezidencat që administrojnë ndërmarrja S&D Invest SHA dhe përkatësisht për objektet Kodra e Diellit 1 & 2 janë shprehur si më poshtë:

- Ndërmarrja shprehet se në objektet nuk kanë akses.
- Ndërmarrja shprehet se në objektet kanë abonentë.
- Ndërmarrja shprehet se në objektet nuk kanë akses pasi nuk e lejon administratori.
- Ndërmarrja shprehet se në objektet nuk kanë abonentë.
- Ndërmarrja shprehet se në objektet nuk i lejohet ofrimi i shërbimit nga administrimi i kompleksit.
- Ndërmarrja) shprehet se në objektet kanë abonentë.
- Ndërmarrja shprehet se në objektet kanë vetëm klientë korporatë të cilët kanë krijuar vetë aksesin, ndërsa për abonentët familjarë nuk janë lejuar të zhvillojnë rrjetin.

- Ndërmarrja shprehet se në objektet nuk ofrohet shërbim pasi ka hasur pengesa nga administratorët. Ndërkohë ndërmarrja vë në dukje se në listën ku bëjnë pjesë dhe objektet ?, në shumicën dërrmuese të rasteve, pengesë është bërë ekzistenca e një marrëveshje tjetër e cila përmban terma të ekskluzivitetit, por pa përmendur në veçanti objektin në fjalë.

23. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar ndërmarrja SHPK me shkresat nr. 23/120 dhe 23/121 prot., të datës 29.07.2024 ka dërguar informacion në lidhje me tarifën që aplikohen për shërbimin e internetit në rezidencat e administruara prej ndërmarrjes S&D Invest SHA, duke specifikuar se:

- Nuk kanë mbulim me rrjet në këto të rezidenca të administruara prej S&D Invest SHA:
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Rezidencën
 - Rezidencën
- Nuk kanë klientë aktiv në këto të rezidenca të administruara prej S&D Invest SHA:
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
 - Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën.

24. me shkresat nr. 23/120 dhe 23/121 prot., të datës 29.07.2024 specifikon se ka vetëm një abonentë në rezidencën e administruar prej S&D INVEST SHA në: “, ndodhur në rrugën ”, i cili është biznes dhe tarifohet me vlerën prej lekë/muaj.

25. Ndërmarrja me shkresën nr. 23/115 prot., të datës 16.07.2024 ka depozituar informacion në lidhje me shërbimin e internetit në rezidencat e administruara prej ndërmarrjes S&D INVEST SHA, duke specifikuar se në: Ndërtesën Nr. , Rezidencën dhe të ndodhur në rrugën dhe në ndodhur në rrugën ndërmarrja nuk është lejuar nga ndërtuesi për të zhvilluar rrjet.

26. Ndërmarrja A me shkresën nr. 23/116 prot., të datës 25.07.2024 ka depozituar informacion në lidhje me shërbimin e internetit në rezidencat e administruara prej ndërmarrjes S&D INVEST SHA, duke specifikuar se nuk ka akses në këto rezidenca:

- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën
- Ndërtesa Nr. ndodhur në rrugën.
- Rezidencën
- Rezidencën

27. Ndërsa në 3 rezidenca të tjera të administruara prej ndërmarrjes S&D Invest SHA, ndërmarrja në ndërtesën nr. ka vetëm abonent, në ndërtesën nr. ka abonentë dhe në ndërtesën nr. ka abonentë dhe tarifon abonentet e saj në këto tre rezidenca banimi me tarifa që variojnë nga Lekë deri në Lekë duke qenë se paketat kanë emërtime të ndryshme dhe mënyra e shpërndarjes në të gjitha rastet është me fibër optike.

28. Ndërmarrja [redacted] ka depozituar informacion në lidhje me shërbimin e internetit në rezidencat e administruara prej ndërmarrjes S&D Invest SHA, duke specifikuar se nuk ka akses në këto rezidenca, përveçse në rezidenca që është [redacted] në rrugën [redacted] dhe [redacted] në rrugën [redacted] dhe tarifatat variojnë nga [redacted] lekë/muaj në [redacted] lekë/muaj.
29. Ndërmarrja [redacted] me shkresën nr. 23/118 prot., të datës 25.07.2024 ka depozituar informacion në lidhje me shërbimin e internetit në rezidencat e administruara prej ndërmarrjes S&D Invest SHA, duke specifikuar se nuk ka akses [redacted] dhe [redacted].
30. Rezulton se ortak i vetëm i ndërmarrjes S&D Invest SHA është Z. Gentian Sula, ndërsa ndërmarrja Selcom SHPK ka dy ortakë: Z. Gentian Sula me 65% dhe Z. Altin Bushka me 35%. Si rezultat, me Z. Gentian Sula që zotëron shumicën e pjesëve të ortakërisë në Selcom SHPK, të dy ndërmarrjet kanë pronësi të njëjtë.
31. Ndërmarrja [redacted] ka depozituar informacion në lidhje me shërbimin e internetit në rezidencat e administruara prej ndërmarrjes S&D Invest SHA, nga ku vihet re se, ndërmarrja [redacted] është e pranishme në rezidencat e banimit të administruara nga S&D Invest SHA duke ofruar vetëm shërbimin e internetit dhe jo paketa që përfshijnë dhe kanalet televizive. Mënyra e shpërndarjes nëpër rezidenca ofrohet vetëm nëpërmjet fibrës optike dhe tarifatat në pjesën më të madhe kanë vlerën [redacted] lekë/muaj dhe [redacted] lekë/muaj, përveçse në rezidencat [redacted] ku shërbimi i internetit varion deri në vlerën [redacted] lekë/muaj.
32. Numrin më të madh të abonentëve [redacted] i ka në rezidencat [redacted], ku te [redacted] ka [redacted] abonentë dhe të [redacted] ka [redacted] abonentë.
33. Ndërmarrja [redacted] ka [redacted] abonentë, në rezidencat [redacted], e cila administrohet nga S&D Invest SHA. Këto rezidenca kanë së bashku rreth [redacted] hyrje, ku [redacted] të abonentëve i ka ndërmarrja [redacted].
34. Nga të dhënat e administruara rezulton se ndërmarrja [redacted] në rezidencat [redacted], ka refuzuar aksesin për [redacted] ndërmarrje që ofrojnë shërbimin e internetit dhe përkatësisht: [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], dhe [redacted].
35. Nëpërmjet shkresës nr. 23/131 prot., datë 08.11.2024 “Depozitimi i angazhimeve vullnetare të shoqërisë S&D Invest SHA në bazë të Rregullores “Për procedurat e angazhimeve”, ndërmarrja S&D Invest SHA ka paraqitur vullnetarisht angazhimet e tyre me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura të konkurrencës në tregun objekt hetimi.
36. Në përputhje me nenin 45, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”, ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime për të adresuar shqetësimet e identifikuar të konkurrencës.
37. Procedurat me angazhime çojnë në marrjen e vendimeve me angazhime, të cilat pas miratimit bëhen detyruese për ndërmarrjet të cilave iu adresohet ky vendim si dhe çon në përfundimin e

procedurave hetimore. Pra autoriteti vlerëson se angazhimet, të cilat janë detyruese, krijojnë siguri ligjore, rivendosin konkurrencën në treg dhe sigurojnë ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme.

38. Nga angazhimet e depozituara të ndërmarrjes S&D Invest SHA, janë vlerësuar se janë të mjaftueshme për të adresuar shqetësimet e konkurrencës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, duke i përcaktuar këto angazhime si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.

39. Sa më sipër, vlerësojmë se këto angazhime mund të sjellin një ndryshim me të shpejtë dhe efektiv në treg, duke eliminuar shqetësimet e ngritura të konkurrencës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit si dhe duke dhënë garanci për sjelljen e ndërmarrjes S&D Invest SHA për të qenë në përputhje me Ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në veçanti me nenin 9.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5, nenin 45, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”, miratuar me VKK nr. 437, datë 05.10.2016.

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes S&D Invest SHA në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja S&D Invest SHA si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si vijon:
 1. Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin që në rezidencat e administruara prej saj, të lejojë aksesin dhe për ndërmarrjet e tjera të cilat e kërkojnë këtë akses për të ofruar shërbimin e internetit.
 2. Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese, veçanërisht:
 - a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
 - c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë
- III. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes S&D Invest SHA në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrja ka në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja S&D Invest SHA, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr.

9121/2003, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA  Zx/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar	Fatjola DELIJA  Anëtar
---	---	--	--


Denar BIBA
Kryetar